



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.955/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj-Sheremeti, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Banka Kombëtare Tregtare sh.a, rr. Ukshin Hoti” nr.29 Prishtinë, ndaj debitorëve Kompania Meti-Compani shpk, nr. Biznesi 71246612. me seli ne Sojevë p.n Ferizaj, te cilën e përfaqëson pronari M.D nga fshati Pozheran Komuna Viti rr.”Hysen Dragobuzhda” dhe debitorët I.D dhe S.D nga fshati Pozheran Komuna Viti rr.”Hysen Dragobuzhda”, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur sipas ankesës së debitorit M.D, te paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë– Departamenti për çështje ekonomike KPPP.nr.1372/22 dt.23.05.2023, me datë 06.11.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit M.D nga fshati Pozheran Komuna Viti rr.”Hysen Dragobuzhda”, kurse aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë– Departamenti për çështje ekonomike KPPP.nr.1372/22 dt.23.05.2023, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë– Departamenti për çështje ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1372/22 dt.23.05.2023, ka refuzuar si te pabazuar prapësimin debitorëve Kompania Meti-Compani shpk, nr. Biznesi 71246612. me seli ne Sojevë p.n Ferizaj, te cilën e përfaqëson pronari M.D nga fshati Pozheran Komuna Viti rr.”Hysen Dragobuzhda” dhe debitorët I.D dhe S.D nga fshati Pozheran Komuna Viti rr.”Hysen Dragobuzhda” te ushtruar ndaj urdhrorit përmbarimor P.nr.691/2021 dt.17.08.2021 te Përmbaruesit Privat, Bardh Tasholli, për territorin e Gjykatës Themelore ne Ferizaj.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori M.D nga fshati Pozheran Komuna Viti rr.”Hysen Dragobuzhda”, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës Kontestimore dhe Përmbartimore, konstatimit të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë, aktvendimin e atakuar ta anuloj dhe çështja të kthehet në shkallë të parë në rivendosje si dhe të aprovohet kërkesa për shpenzimet e përpilimit të ankesës sipas tarifës së OAK.

Përgjigje ndaj ankesës së debitorëve ka ushtruar kreditori, me arsyetimin se pretendimet e debitorëve janë të pabazuara dhe me qëllim të zvarritjes së procedurës, andaj propozon që gjykata e shkallës së dytë këtë ankesë ta refuzoj ndërsa urdhrin përmbartimor ta vërtetoj.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorëve është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Banka Kombëtare Tregtare sh.a, rr. “Ukshin Hoti” nr.29 Prishtinë, me datën 17.08.2021 ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorëve Kompania “Meti-Compani” shpk, nr. Biznesi 71246612. me seli në Sojevë p.n Ferizaj, të cilën e përfaqëson pronari M.D nga fshati Pozheran Komuna Viti rr.”Hysen Dragobuzhda” dhe debitorët I.D dhe S.D nga fshati Pozheran Komuna Viti rr.”Hysen Dragobuzhda”, në bazë të dokumentit përmbartues: Kontrata për Kredi Bankare nr.8617/18, Aneksi i Çeljes dhe Përdorimit të Kredisë, Kontrata për Hipotekën LRP.nr.2445/2018 ref.nr.575/2018 dt.27.05.2018, Aktvendim mbi Regjistrimit të Hipotekës nr.prot.420/2018 dt.,30.05.2018 lëshuar nga Zyra Komunale Kadastrale në Viti, Marrëveshje mbi Pengun nr. 8617/18 dt. 28.05.2018, Konfirmim regjistrimi R-20180601-276 dt.01.06.2018, i lëshuar nga Zyra për Regjistrim të Pengut pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Përmbartuesi Privat Bardh Tasholli nga Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.691/21 dst.,17.08.2021, ka lejuar përmbartimin për shumën

e detyrimit të debitorëve ndaj kreditorit që rrjedh nga marrëveshjet e sipër cekura, në vlerë totale prej 52,497.06 euro, si edhe shpenzimet përbarimore.

Kundër këtij urdhri, me datën 06.09.2021, debitorët kanë ushtuar prapësim, me pretendimin se urdhri përbarimor është lëshuar në bazë të dokumentit jo përbarimor i cili nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument përbarimor, propozojnë që gjykata të caktoj seancë dëgjimore konform nenit 73 të LPP dhe që pas shqyrtimit të pretendimeve si në prapësim gjykata ta hedh propozimin për përbarim si të pabazuar.

Përgjigje në prapësimin e debitorëve me datën 06.09.2021 ka paraqitur kreditori, me pretendimin se urdhri përbarimor është në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të nenit 22 të LPP, Kontrata për Hipotekën dhe Kontrata për Pengun janë të regjistruara në regjistrat zyrtar dhe si të tilla paraqesin titull ekzekutiv dhe janë përcaktuar si dokumente përbarimore. Pretendimet debitorëve nuk paraqesin kurrfarë argumenti për të goditur urdhrin përbarimor dhe nuk janë në pajtim me nenin 69 par.4 të LPP, andaj propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorëve si të paargumentuar dhe urdhrin përbarimor ta vërtetoj.

Gjykata Komerciale e Kosovës–Dhoma e Shkalles së Parë - Departamenti për çështje ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1372/22 dt.23.05.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur definitivisht si në dispozitiv të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka arsyetuar se ka analizuar dokumentet përbarimore si Kontrata për Kredi Bankare nr.8617/18, Aneksi i Çeljes dhe Përdorimit të Kredisë, Kontrate për Hipotekën LRP.nr.2445/2018 ref.nr.575/2018 dt.27.05.2018, Aktvendim mbi Regjistrimit e Hipotekës nr.prot.420/2018 dt.,30.05.2018 lëshuar nga Zyra Komunale Kadastrale në Viti, Marrëveshje mbi Pengun nr. 8617/18 dt. 28.05.2018, Konfirmim regjistrimi R-20180601-276 dt.01.06.2018 dhe vlerëson se këto dokumente përbejnë bazë juridike për caktimin e përbarimit dhe janë të përshtatshme për përbarim, dhe mbi këtë bazë e vlerësoi si të pabazuar propozimin e debitorëve për caktimin e seancës dëgjimore, gjykata bëri shikimin e të gjitha shkresave në lëndë dhe vlerësoi se pretendimet e debitorëve janë të pabazuara dhe jo konform nenit 69 par.4 të LPP andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj vendimin e gjykatës se shkalles se parë lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se baza juridike për caktimin e përmbarimit, kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të caktuar përmbarimin sipas dokumentit të përmbarimit, parashihen sipas dispozitës së nenit 22 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, dhe në prapësimin e debitorit nuk janë paraqitur asnjë nga shkaqet të cilat janë parapara në nenin 71 të LPP-së, që do të pengonin përmbarimin e lejuar.

Dhoma e Shkalles se Dytë, bazuar ne shkresat e lendes vlerëson se Gjykata e shkalles se parë drejt ka vlerësuar se marrëveshjet mbi bazën e te cilave është mbështetur propozimi për përmbarim e saktësisht Kontrata për Kredi Bankare nr.8617/18, Kontrata për Hipotekën LRP.nr.2445/2018 ref.nr.575/2018 dt.27.05.2018, Aktvendim mbi Regjistrimit e Hipotekës nr.prot.420/2018 dyt.,30.05.2018 lëshuar nga Zyra Komunale Kadastrale ne Viti, Marrëveshje mbi Pengun nr. 8617/18 dt. 28.05.2018, janë te noterizuara tek noter S.Sh me seli ne Ferizaj rr. “Reçakur” dhe paraqesin titull ekzekutiv, pra ashtu siç parasheh neni 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “*Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri*”, pra janë dokumente përmbarimore, te përcaktuara me ligj dhe se Kontrata e Pengut është e rregulluar me dispozita ligjore dhe atë sipas nenit 5 paragrafi 2 të Ligjit nr.05/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPP-së, i cili shprehimisht përcakton: *Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1, pas nën-paragrafit 1.7, shtohet nën-paragraf i ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut*”, gjë që kontratat sikurse ajo për Hipotekën dhe ajo e Pengut janë te regjistruara nga zyrat përkatëse te regjistrimit, me çka janë

përbushur të gjitha kushtet e parapara ligjore për lejimin e përmbarimit dhe në të njëjtën kohë edhe për refuzimin e prapësimit. Kjo gjykatë i analizoi pretendimet e palës debitore se ekzistojnë të gjitha arsyet për anulimin e urdhrin për përmbarim dhe se dokumentet mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi nuk i plotësojnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm të parapara me nenin 27 dhe 29 par.1.3 të LPP, por të njëjtat pretendime nuk qëndrojnë sepse rezultojnë si të pathemelta dhe të paargumentuara me prova konkrete dhe jo siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, ashtu që i refuzoi si të pabazuara ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e vërtetoi.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.955/23, me datë 06.11.2023

Gjyqtarja

Saranda Bogaj-Sheremeti